

Data 09.09.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje transformatorë instrumental TU&TM (transformator rryme TM&TU, transformator tensioni, automat limitator)”

---

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **31682310-6 - Pajisje të tensionit të mesëm**

---

VLERA E FONDIT LIMIT: **52,926,729.31** (pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë pikë tridhjetë e një) **Lekë pa TVSH.**

Në Euro: **530,753.4** (pesëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre pikë kater) **Euro pa TVSH.**

---

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë data **09.09.2024**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Tirane” ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsyetimit të mëposhtem:**

Eshte e pamundur qe kjo procedure te ndahet ne lote nga vete natyra e saj duke pasur parasysh:

- Mallrat objekt prokurimi jane pjese integrale e nje paneli elektrik i cili asamblohet dhe funksionon si nje i vetem;
- Mungese e njerit prej artikujve krijon mosfunksionimin e sistemit te matjes, duke qene se jane komponente te tij;
- koordinimin e grupeve per proceset e punes qe do te kryhen;
- planin e shperndarjes te miratuar nga OSSH qender per të gjitha drejtoritë e rajoneve
- përfitime financiare në formë të uljeve në çmim për shkak të vëllimit të madh të blerjeve. kushte më të mira në lidhje me çmimin e ofertuar.

Kontraktuesi qe do të ofrojë keto pajisje, duhet te zoteroje manualeve të detajuar të instalimit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe dokumenteve të tjera të specifikuara në Specifikimet Teknike. Per kete arsye, te gjitha proceset e ketij furnizimi, qe te funksionojne dhe te meren ne dorezim ne kohe me cilesine dhe garancine e nevojshme duhet te realizohet ne nje procedure te vetme dhe per pergjegjesine e proceseve nga nje operator ose bashkim operatoresh.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor **”Drejtoia Rajonale Tiranë OSSH sh.a”**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e materialeve dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e

duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera e xhiros për te pakten nje nga vitet e kerkuara te jete ne masën e fondit limit qe prokurohet, duke qendruar madje brenda normes prej 100 % te vleres se fondit limit qe prokurohet, norme me e ulet se ajo qe percaktohet si limit i mundshem nga LPP 162/2020

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”.

---

*2.2.3 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkitë) për shlyerjen e taksave vendore per gjashtëmujorin e parë te vitit 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-së.*

*\*\*\* Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.*

**Argumentim:** Ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këto objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të këto realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këto mënyre, AK krijon sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

---

## 2.4 Dokumentacioni për mallrat:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit për çdo artikull të kërkuar (sipas preventivit). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

**Argumentimi:** Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky

kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes paneleve të tensionit të ulet dhe transformatoreve instrumentale.

**Së pari**, paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte.

**Së dyti**, kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plote të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

**Së treti**, kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

**Në përfundim**, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në procesin e blerjes. Ky kriter siguron se operatorët ekonomikë janë të kompetentë dhe të lidhur zyrtarisht me prodhuesin, dhe siguron një bazë të fortë për një marrëveshje të ndershme dhe të cilësuar në procesin e blerjes. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme.

2. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut /eve te

prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

\*\*\* Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

**Argumentim:** Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

**Së pari,** paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

**Së dyti,** kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Fragmentet e katalogut tregojnë se operatori ekonomik ka kujdes për detajet dhe është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe pajtueshmërisë.

**Së treti,** kriteri për përkthimin dhe noterizimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerjes. Përkthimi dhe noterizimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

**Në përfundim,** vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i arsyeshëm dhe i nevojshëm për të siguruar transparencën dhe cilësinë në procesin e blerjes së mallrave. Ky kriter promovon një komunikim të qartë dhe të kuptueshëm, siguron përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standartit, dhe ndihmon në garantimin e një procesi të drejtë dhe të cilësisë së lartë të blerjes së mallrave. Kjo është një mënyrë e mirë për të siguruar suksesin dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit.

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kjo kerkese eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e deshmive të testimeve zyrtare te mallrave është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të blera me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara..

**Së pari,** paraqitja e deshmive të testimeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

**Së dyti,** kriteri për deshmite e testimeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testimeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale.

**Së treti,** kriteri për deshmi të testimeve zyrtare promovon transparencën dhe drejtësinë në procesin e tenderimit. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testimeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e deshmive të testimeve zyrtare është një hap i arsyeshëm dhe ndihmon në garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë së mallrave me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Ky kriter promovon transparencën, redukton rreziqet dhe siguron një proces të drejtë dhe të efektshëm. Kjo është një mënyrë e mirë për të siguruar se procedura e planifikuar do të realizohet me sukses.

4. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;

\*\*\* Ne rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë çertifikatën ISO, pasi duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratës së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. i ndryshuar.



Vendosja e kriterit për operatorin ekonomik ofertues të pajisur me Certifikatën ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë është një hap i arsyeshëm dhe i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e punës dhe zbatimin e kontratës. Kriteri për Certifikatën ISO 9001 është i rëndësishëm për të siguruar cilësi, efikasitet dhe besueshmëri.

**Së pari**, Certifikata ISO 9001 tregon se operatori ekonomik është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe menaxhimit të proceseve. Ky standard ndjek një qasje sistematike dhe të dokumentuar për të menaxhuar cilësinë në të gjitha fazat e procesit të prodhimit ose shërbimit. Përdorimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë të bazuar në ISO 9001 siguron që operatori ekonomik është në gjendje të identifikojë, monitorojë dhe korigjojë problemet e cilësisë në mënyrë efikase.

**Së dyti**, ky kriter siguron që operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike të tenderit. Certifikata ISO 9001 paraqet një vërtetim të jashtëm të aftësisë së operatorit ekonomik për të kryer punën me cilësi të lartë dhe në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtare.

**Së treti**, ky kriter siguron që operatori ekonomik është i aftë për menaxhim të mirë të punës dhe për të zbatuar efikasitetin operacional. Një sistem i menaxhimit të cilësisë sipas ISO 9001 përfshin procedura të dokumentuara dhe një qasje të planifikuar ndaj risqeve. Kjo ndihmon në planifikimin e mirë të furnizimit të mallrave dhe në parandalimin e gabimeve dhe dështimeve të mundshme gjatë punës.

**Në përfundim**, ky kriter siguron cilësi, efikasitet dhe besueshmëri në zbatimin e procesit të furnizimit të mallrave, siguron përmbushjen e standarteve të kërkuara dhe ndihmon në menaxhimin e cilësisë dhe rreziqeve të mundshme. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar një proces të suksesshëm të blerjes dhe realizimit të tyre.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standardit ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standardit ISO 9001 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

**Argumentimi:** Ky kriter është proporcional me objektin e kontrates, si dhe është në zbatim të Nenit 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për të vërtetuar konformitetin prodhimit të produkteve të procedurës së prokurimit.

Kriteri i markimit CE është një stantart i rëndësishëm në tregun e mallrave të kërkuara, dhe ka disa arsye të qarta pse është përdorur në këtë procedurë.

**Së pari,** markimi CE është një dëshmi e qartë e pajisjes me mallra të përshtatshme për përdorim në tregun evropian. Ky markim tregon se veglat janë prodhuar dhe testuar në përputhje me standarde të caktuara evropiane për cilësi dhe siguri.

**Së dyti,** markimi CE promovon konkurrencën e drejtë në treg. Nëse operatorët ekonomikë nuk janë të detyruar të paraqesin deklaratatë të konformitetit me këtë kriter, atëherë ka rrezik që disa prej tyre të përdorin mallra të cilësisë së ulët ose të rrezikshme. Kjo mund të shkaktojë jo vetëm rreziqe për punonjësit, por edhe konkurrencë të padrejte për ata operatorë ekonomikë që kanë investuar në mallra cilësore dhe të sigurta.

**Së treti,** markimi CE është i rëndësishëm për përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret. Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, mallrat janë të detyruara të plotësojnë këto standarde të sigurisë dhe cilësisë për të qenë të ligjshme.

**Në përfundim** ky kriter siguron cilësinë, sigurinë dhe konkurrencën e drejtë në treg dhe ndihmon në përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike për mallrat (sipas preventivit) në të cilën duhet të paraqiten të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe web i firmës furnizuese.

**Argumentim: Së pari,** skeda teknike me të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe webit të furnizuesit ofron një nivel të lartë të transparencës në procesin e tenderimit. Kjo transparencë është e rëndësishme për të siguruar që të gjithë operatorët ekonomikë kanë akses në informacionin e nevojshëm për të bërë një vlerësim të saktë të produkteve dhe ofertave të tyre.

**Së dyti,** ky kriter siguron që operatorët ekonomikë janë të përgatitur dhe të informuar mirë për mallrat që duan të blejnë. Me të dhënat e sakta të kodit të produktit dhe faqes së internetit të furnizuesit, ata kanë mundësi të marrin informacion më të thellë dhe të ndërtojnë një kuptim më të mirë për cilësitë dhe karakteristikat e mallrave të ofruara nga furnizuesi. Kjo i ndihmon ata të bëjnë zgjedhjen e duhur në përputhje me nevojat dhe synimet e tyre konkrete.

Për këto arsye ky kriter promovon transparencën, ndihmon operatorët ekonomikë të jenë të përgatitur dhe të informuar mirë, dhe siguron integritetin e informacionit të paraqitur në procesin e tenderimit. Kjo është në përputhje me synimet për një proces të drejtë dhe të hapur të blerjes së mallrave.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, me mallrat e të cilit OE do të paraqitet në tender.
- b. Emërtimi i Katalogut ose i skedës teknike
- c. Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- d. Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese /ose i distributorit të autorizuar	Emërtimi i katalogut të prodhuesit	Nr.i faqes	Numri identifikues i artikullit
1.				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, persa i perket ofertes teknike.

**Së pari,** ofrimi teknik kërkon që operatorët ekonomikë të paraqesin një përshkrim të detajuar të mallrave që ofrojnë. Përmes kësaj kërkesë, AK ka një pamje të qartë të cilësive të mallrave dhe mund të krahasojnë ofertat në mënyrë objektive për të zgjedhur atë që plotëson më mirë nevojat e tyre.

**Së dyti,** ofrimi teknik i jep AK-se një shans për të vlerësuar aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë. Përmes analizës së ofertave teknike, AK mund të vlerësojnë nëse operatori ekonomik ka njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të përdorur dhe mirëmbajtur mallrat që ofron.

**Së treti,** nëse operatori ekonomik nuk paraqet një ofertë teknike të plotë dhe të qartë, AK mund të hasë vështirësi në vlerësim.

Për këto arsye, vendosja e kriterit të paraqitjes së ofertës teknike është i arsyeshëm dhe e ndihmon në sigurimin e një procesi të drejtë dhe të efektshëm të blerjes. Ky kriter jep informacion të rëndësishëm, siguron cilësi të mallrave. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me keto mallra të realizohet me sukses.

9. Në funksion të plotësimin të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit të identifikimit (shqiptar ose te huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, perfaqesues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

10. Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratatë të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qender derguar me e mail ne Drejtorine Rajonale Tirane e OSSH sh.a. Fondi Limit , afati i levrimit eshte hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

**Data** 10.10.2024      **Ora** 11:00

**Vendi:** në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**